



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

Olimpiada e gjuhës shqipe dhe letërsisë

Faza II

Viti shkollor 2015-2016

Klasa 12

2 prill 2016

Kjo skemë vlerësimi është orientuese.

Përgjigjet e nxënësve do të vlerësohen duke u bazuar në kriteret e dhëna më poshtë. Secili kriter ka një total pikësh. Nxënësi duhet të shfaqë disa kompetenca për secilin kriter, të cilat qartësohen në tabelën përkatëse. Kjo tabelë shpreh në mënyrë të detajuar se çfarë duhet të përmbushë nxënësi për të marrë pikë të plota apo ndërmjetëse.

1. Vështirësitë e jetës janë prova më e mirë për personazhet e një vepre.

Analizoni mënyrat me të cilat personazhet janë paraqitur në dy vepra që keni studiuar dhe vlerësoni nëse është i drejtë ky pohim. **20 pikë**

Rubrikat e vlerësimit

- I. Kuptimi dhe zhvillimi:** përgjigjja e dhënë dëshmon se nxënësi e ka kuptuar pyetjen dhe përmes interpretimeve dhe analizave që ai zhvillon (në tekstin ose tekstet e marra në shqyrtim).
-Zhvillon idetë, duke përdorur detaje specifike të përzgjedhura me shumë kujdes. **5 pikë**
- II. Organizimi:** përgjigjja shfaqet e orientuar, organizuar dhe koherente. **5 pikë**
- III. Përdorimi gjuhësor:** përgjigjja e dhënë shfaq qartë qëllimi dhe ndjeshmëri ndaj audiencës (së cilës i drejtohet) dhe për t'ia arritur kësaj përdor në mënyrë efektive fjalët dhe fjali të shumëllojshme (në formë dhe përmbajtje). **5 pikë**
- IV. Saktësia gjuhësore:** përgjigjja e dhënë respekton rregullat e drejtshkrimit, shenjave të pikësimit dhe shkronjës së madhe. **5 pikë**

2. Letërsia rrotullohet rreth *muzikës* së gjuhës dhe jo rreth komunikimit të ideve.

Duke u bazuar në të paktën dy vepra që keni studiuar, argumentoni nëse jeni dakord me këtë pohim.

15 pikë

Rubrikat e vlerësimit

- I. **Kuptimi:** përgjigjja e dhënë dëshmon se nxënësi e ka kuptuar pyetjen dhe shpreh qartë pozicionin përmes interpretimeve dhe analizave që ai zhvillon (në tekstin ose tekstet e marra në shqyrtim). **3 pikë**
- II. **Zhvillimi:** përgjigjja e dhënë përmban detaje specifike të përzgjedhura me shumë kujdes. **3 pikë**
- III. **Organizimi:** përgjigjja shfaqet e orientuar, organizuar dhe koherente. **3 pikë**
- IV. **Përdorimi gjuhësor:** përgjigjja e dhënë shfaq qartë qëllimi dhe ndjeshmëri ndaj audiencës (së cilës i drejtohet) dhe për t'ia arritur kësaj përdor në mënyrë efektive fjalët dhe fjali të shumëllojshme (në formë dhe përmbajtje). **3 pikë**
- V. **Saktësia gjuhësore:** përgjigjja e dhënë respekton rregullat e drejtshkrimit, shenjave të pikësimit dhe shkronjës së madhe. **3 pikë**

3. Ne e kuptojmë rëndësinë e kohës vetëm kur na ka mbetur shumë pak prej saj. A jeni dakord apo jo me këtë pohim? Pse? Argumentoni mendimin me shembuj nga përvoja juaj ose e njerëzve që njihni.

15 pikë

Rubrikat e vlerësimit

- I. Kuptimi dhe zhvillimi:** përgjigja e dhënë dëshmon se nxënësi e ka kuptuar pyetjen dhe përmes interpretimeve dhe vlerësimeve që ai zhvillon (në tekstin ose tekstet e marra në shqyrtim). **3 pikë**
- II. Zhvillimi:** përgjigja e dhënë përmban detaje specifike të përzgjedhura me shumë kujdes. **3 pikë**
- III. Organizimi:** përgjigja shfaqet e orientuar, organizuar dhe koherente. **3 pikë**
- IV. Përdorimi gjuhësor:** përgjigja e dhënë shfaq qartë qëllimi dhe ndjeshmëri ndaj audiencës (së cilës i drejtohet) dhe për t'ia arritur kësaj përdor në mënyrë efektive fjalët dhe fjali të shumëllojshme (në formë dhe përmbajtje). **3 pikë**
- V. Saktësia gjuhësore:** përgjigja e dhënë respekton rregullat e drejtshkrimit, shenjave të pikësimit dhe shkronjës së madhe. **3 pikë**